



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË DOGANËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2021

**Prishtinë, maj 2022**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Doganës së Kosovës (DK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të DK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin

e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës së Kosovës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Doganës së Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Doganës së Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Doganës së Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq

përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme;

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm;
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Doganës së Kosovës;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti; dhe
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Dogana e Kosovës ka arkëtuar rreth 31% të hyra më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në kontekst të gjetjeve vërehet mungesë e planeve për rekrutim dhe pozita të pa plotësuara menaxheriale si dhe mangësi në menaxhimin e pasurive ku pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrin e e-Pasurisë përfshirë edhe menaxhimin e pasurive të amortizuara. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 5,815,101€ dhe i njëjti ishte shpenzuar 100%.

#### **Çështja A1 - Mungesa e planit të rekrutimit dhe pozitat menaxheriale të paplotësuara**

**Gjetja** Sipas planit të shpërndarjes së stafit me nr. Protokollit 01/837 të datës 16.03.2021 i bërë në bazë të UA nr.59/2019 për ndryshim plotësim të UA nr.39/2017 për strukturën organizative, Dogana kishte të aprovuar 581 punonjës, përderisa numri i zyrtarëve në fund të vitit 2021 ishte 559.

Për vitin 2021, Dogana edhe pse kishte fonde (sipas Ligjit të buxhetit), nuk kishte përgatitur plan për rekrutim të stafit dhe si rrjedhojë nuk ishte zhvilluar asnjë proces të rekrutimit të jashtëm. Po ashtu, nuk ishin zhvilluar as procese për avancim të brendshëm përkundër faktit se në fund të vitit, 26 pozita menaxheriale ishin të lira (5 pozita ishin të mbuluara me zëvendësues, 8 me emërim të përkohshme ndërsa 13 të paplotësuara fare).

Sipas zyrtarëve të DK, kjo situatë qëndron për arsye se janë duke u bërë disa korrigjime në udhëzimin përkatës administrativ për rregullimin e marrëdhënies së punës për oficerët doganor, por që kjo gjendje po vazhdon ende.

**Ndikimi** Mos plotësimi i pozitave të planifikuara me staf, sidomos ato menaxhuese, mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e zhvillimit të aktiviteteve operacionale dhe arritjen e objektivave të përcaktuara të Doganës.

**Rekomandimi A1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për aprovimin e Udhëzimeve përkatëse dhe plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Strukturës Organizative, duke i dhënë rëndësi të veçantë pozitave menaxhuese në kuadër të organizatës

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 3,714,709.14€, pasurive jokatitale është 371,098.97€, si dhe e stoqeve 210,692.38€.

### Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive jo financiare

#### Gjetja

Sipas nenit 6, pika 3 e Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu, neni 2 thekson se të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Ne identifikuam që:

- 16 ram memorie për serverë në vlerë 9,361€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria;
- Dogana ende nuk ka një regjistër të plotë të pasurisë nën 1,000€ në sistemin “e pasuria”. Evidencat për pasuritë jo kapitale nën 1,000€ mbahen në dy regjistra të ndara. Pasuritë jo kapitale të blera nga viti 2018 - 2021 janë të regjistruara në sistemin “e-pasuria” (vlera 220,925€), ndërsa pasuritë tjera (vlera 150,173€) që i përkasin viteve të më hershme (para vitit 2018) janë të evidentuara në një sistem të brendshëm "Inventory"; dhe
- Dy pajisje të TI-së nuk kemi arritur t'i identifikojmë gjatë ekzaminimit fizik, pasi që në depon ku ishin vendosur pasuritë e vjetra ato ishin pa barkode. Në raportin e komisionit të Inventarizimit, 1335 pajisje dhe inventar të cilat kryesisht ishin jashtë përdorimit e kishin statusin “të pagjetura” për të cilat ishte rekomanduar të formohet komisioni për vlerësimin dhe tjetërsimin e tyre. Komisioni kishte klasifikuar pasuritë për asgjësim dhe tjetërsim, kurse pjesën tjetër kishte rekomanduar që atyre tu vendosen barkodet dhe të mbahen në evidencat e pasurive.

Problemi i mos regjistrimit të disa pasurive në e-pasuri vjen nga menaxhimi jo efektiv i tyre nga ana e zyrtarëve të pasurisë, kurse arsyeja e regjistrimit jo të plotë të pasurisë nën 1,000€ në sistemin “e-pasuria” është për shkak të vonësave në bartjen e të gjitha të dhënave nga ana e programerëve të cilët e menaxhojnë këtë softuer (kontratën për këtë softuer e menaxhon Ministria e Punëve të Brendshme).

#### Ndikimi

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive jo kapitale në sistemin “e-pasuria” dhe mbajtja e pasurive të vjetra (jashtë përdorimit) dhe pa barkode përveç që është në kundërshtim me rregulloren, e rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të tyre në PFV.



**Rekomandimi C1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë nën 1000€ regjistrohen në sistemin e-Pasuria dhe të ketë një menaxhimi efektiv të pasurive të amortizuara - jashtë përdorimit në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>10,341,588</b>	<b>9,850,810</b>	<b>8,362,746</b>	<b>8,754,823</b>	<b>9,132,805</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	10,341,588	9,844,810	8,362,746	8,677,987	8,883,723
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	76,836	249,082
Donacionet e jashtme	0	6,000	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 490,779€. Kjo ulje është si rezultat i reduktimit të buxhetit me rishikim dhe ndryshimeve buxhetore me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2021 DK ka shpenzuar 85% të buxhetit përfundimtar ose € 8,362,746.29 me një ulje prej 7% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>10,341,588</b>	<b>9,850,810</b>	<b>8,362,746</b>	<b>8,754,823</b>	<b>9,132,805</b>
Pagat dhe mëditjet	6,417,127	5,815,101	5,815,101	5,933,072	6,206,248
Mallrat dhe shërbimet	2,055,086	2,098,749	1,977,692	1,686,590	2,011,941
Komunalitë	169,375	64,530	60,602	93,795	109,088
Investimet Kapitale	1,700,000	1,872,430	509,352	1,041,367	805,528


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje kishte pësuar ndryshime në krahasim me buxhetin fillestar, duke qenë më i ulët për 602,026€. Zvogëlimi kishte ndodhur si rezultat i mos rekrutimit të stafit sipas strukturës organizative të DK-së;
- Buxheti final i Mallrave dhe Shërbimeve dhe komunalive ishte zvogëluar për 61,182€ kjo si rezultat i rishikimit buxhetor dhe pastaj edhe i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore;

- Buxheti final për shpenzimet kapitale ishte 1,872,430€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 509,352€ apo 27%. Dogana kishte paraparë të realizonte 11 projekte, katër prej të cilëve nuk ishin realizuar fare, dy në mungesë të ofertuesve të përgjegjshëm ndërsa për dy të tjerët procedurat kishin përfunduar në fund të vitit 2021.

Në kuadër të shpenzimeve të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ishin të përfshira edhe shpenzimet e Covid-19 në vlerë 4,025€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin 08/L-016 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021 ishin 1,173,000,000€. Ndërkaq, me Ligjin e rishikuar të buxhetit nr. 07/L-04, vlera e parashikuar e të hyrave doganore ishte rritur në 1,248,400,000€. Nga kjo vlerë, DK kishte arritur të realizonte 1,376,704,600€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 1,373,862,694€, apo 110% e planifikimit (të hyrat bruto 1,376,704,600€ -2,841,906€ kthimet).

Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë rritje. Në vitin 2021, DK kishte realizuar të hyra bruto prej 1,376,704,600€, që në krahasim me vitin 2020, të hyrat ishin 1,052,525,263€ apo rreth 31% më shumë.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Të hyrat bruto	1,173,000,000	1,248,400,000	1,376,704,600	1,052,525,263	1,179,586,031
Kthimet	-4,600,000	-4,600,000	-2,841,906	-1,655,371	-1,786,817
<b>Të hyrat neto</b>	<b>1,168,400,000</b>	<b>1,243,800,000</b>	<b>1,373,862,694</b>	<b>1,050,869,892</b>	<b>1,177,799,214</b>


**Tabela 4. Të hyrat/pranimet e realizuara dhe kthimet sipas kategorive ekonomike në tri vitet e fundit (në €)**

Përshkrimi	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
AKCIZA NË KUFI	501,257,845	397,791,382	430,799,977
AKCIZA E BRENDSHME	37,231	280,768	4,696,218
DOGANA NE IMPORT	124,606,455	101,618,260	130,325,418
MASË MBROJTËSE ANTIDAMPING	116,904	980,311	3,206,985
TVSH NË KUFI - DOGANA	746,548,380	547,645,723	606,406,726
TATIMET TAKSA TJERA NGA DOGANA	448,395	1,919,426	615,256
KUNDËRVAJTJE E DËNIMEVE DOGANORE	816,605	479,218	940,820
TË HYRAT NGA GJYKATA - TË PASPECIFIKUAR	34,871	32,417	57,784
TË HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	258,081	215,971	176,266
BANDEROLAT	468,600	359,538	369,333
PRANIMET NGA TARIFAT PËR VENDIMET GJYQËSORE/PËRMBARIMORE	66,029	42,601	97,794
TË HYRAT PAS ZHDOGANIMIT	2,045,204	1,159,649	1,893,455
<b>Totali i pranimeve bruto</b>	<b>1,376,704,600</b>	<b>1,052,525,263</b>	<b>1,179,586,031</b>
KTHIMI I AKCIZËS	-1,157,985	-464,254	-283,525
KTHIMI I TAKSAVE DOGANORE	-333,775	-362,885	-395,975
KTHIMI I TVSH - DOGANA	-798,841	-792,839	-818,272
KTHIMI - TATIMET TAKSA TJERA NGA DOGANA	-551,305	-35,394	-289,046
<b>Gjithsej shuma e kthimeve</b>	<b>-2,841,906</b>	<b>-1,655,371</b>	<b>-1,786,817</b>
<b>Totali i pranimeve neto (bruto-kthimet)</b>	<b>1,373,862,694</b>	<b>1,050,869,892</b>	<b>1,177,799,214</b>

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të DK-së ka rezultuar në tre (3) rekomandime. DK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, dy (2) rekomandime janë zbatuar; dhe një (1) ishte në proces, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur çeket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit - deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 5 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që planifikimi dhe realizimi i pagesave të bëhet në kategoritë ekonomike të duhura, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.	DK ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe gjatë auditimit të PFV 21 nuk kemi hasur në kësi mangësi.	I zbatuar
2.	Investimet kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të vazhduar periudhën e vlefshmërisë së kontratës në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e saj sipas kushteve të parapara.	Nuk kemi hasur në mangësi të tilla gjatë auditimit të PFV 2021	I zbatuar
3.	Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë jo financiare nën 1,000€ janë të regjistruara në sistemin "e-pasuria", në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë. Po	DK nuk kishte integruar të gjitha pasuritë nën 1000 në sistemin e-pasuria, por	Pjesërisht i zbatuar

	ashtu, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjë harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata. Në rastet kur është e nevojshme, duhet të bëhet edhe vlerësimi i pasurisë bazuar në raportin e inventarizimit.	kishte formuar komisionin e inventarizimit dhe kishte kryer inventarizimin e pasurive.	
--	--	--	--

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit



Aida Podrimaj, Anëtare e ekipit



Edona Abazi, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Agron Lluga  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës  
Data: 05 Maj 2022



Drejtorja e Doganës, Lagja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi Nr. 1, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel & Fax + 383 (0) 38 540 350 / +383 (0) 38 540 836  
[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.